



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 15, Datë 11 / 1 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr.145, datë 08.11.2017, të paraqitur nga subjekti ankues A.Sh, kundër OSHEE sh.a Tiranë dhe Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga A.Sh, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Nga viti 1987 deri në vitin 2014 ka qenë i punësuar pranë OSHEE Shkodër. Në vitin 2001 pas një operacioni të kryer është me protezë në këmbën e majtë. Në gusht të vitit 2013, gjatë punës në terren është aksidentuar, ka dëmtuar protezën, dhe është shtruar në spital. Nga data 12.02.2014 deri më 01.02.2015 ka qenë i trajtuar me Vendim të KMCAP- Shkodër, si invalid i pjesshëm për të punuar 6 orë në ditë. Në datë 27.02.2014 është njoftuar për fillimin e procedurave për largim nga puna. Vendimin për largim nga puna A.Sh e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 1522(5442), datë 15.12.2016 ka vendosur për dëmshpërblimin e paditësit si pasojë e konstatimit të pavlefshmërisë së zgjidhjes së kontratës së punës. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.255, datë 20.04.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rikthimin në punë.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,*

vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 145, datë 08.11.2017, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, A.Sh është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e OSHEE sh.a, Tiranë dhe OSHEE sh.a, Shkodër, që në datë 27.02.2014, periudhë kur A.Sh është vënë në dijeni për fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së A.Sh, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI